33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranimit të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranimit të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

#### **Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet**

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

Numri i Prokurimit: **209-19-6649-5-2-1** Numri i brendshëm: **209/19/034/521**– Titulli **Renovimi i QAP Gjilan dhe QAP Prizren, 2019**

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë pune, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

### **Neni 35 Pranimi përfundimtar**

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimit përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Neni 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

### **Shkelja e kontratës dhe shkëputja**

#### **Neni 36 Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

#### **Neni 37 Shkëputja e kontratës**

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;



Numri i Prokurimit: 209-19-6649-5-2-1 Numri i brendshëm: 209/19/034/521– Titulli **Renovimi i QAP  
Gjilan dhe QAP Prizren, 2019**

b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;

c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;

d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;

e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigojë brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;

f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta lirojë vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

#### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcaktojnë Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësitë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.

ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.

iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcaktojnë Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.

iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.

v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

#### **Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

#### **Neni 40 Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

#### **Neni 41 Lirim nga Ekzekutimi**

Numri i Prokurimit: **209-19-6649-5-2-1** Numri i brendshëm: **209/19/034/521**– Titulli **Renovimi i QAP Gjilan dhe QAP Prizren, 2019**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

#### **Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përipiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### **Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

a) ose vendim nga gjyqi;

b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.



### **PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulojnë nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është <b>10% e vlerës së kontratës në afat prej 70 ditëve.</b>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impiantëve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i> ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i> ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impiantëve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i> ; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[shëno shumat]</i> (ii) të personave të tjerë: <i>[shëno shumat]</i>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda <b>(7 shtatë)</b> ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është <i>[shëno numrin]</i> ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë <b>7 (shtatë) ditë pas nënshkrimit të kontratës.</b>
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë <b>40 ditë.</b>
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <b>0.05%</b> për ditë.  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është <b>10%</b> e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	<i>[Specifikoni nëse një regjistër i punës nuk është nevojitet].</i>  <b>Nuk nevojitet një regjistër i punës, përveç atyre të përcaktuara me Ligjin e Ndërtimit.</b>
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është: <b>Kompania mbikqyrëse “Eng Idea” dhe “Sib Bka”</b>  <b>Sipas nenit 81 të LPP aktual në fuqi, Menagjimin e Kontratës nga ana e MPMS: Luan Kastrati,</b>

Numri i Prokurimit: 209-19-6649-5-2-1 Numri i brendshëm: 209/19/034/521– Titulli **Renovimi i QAP Gjilan dhe QAP Prizren, 2019**

Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: <b>PARAPAGIMI (AVANSI) NUK APLIKOHET</b>
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: <b>10% e vlerës së punëve të kryera do të ndalet në afat 1 vjeçar pas pranimit teknik të punimeve dhe para lëshimit të pagesës përfundimtare do të depozitohet kontraktori në formë të garancionit.</b>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë <b>7 shtatë</b> ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është <b>365 ditë (1 vit).</b>
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është <i>[shëno përqindjen]</i> .
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, përgjegjës për zgjidhjen e tyre do të jetë Menaxheri i Kontratës-MPMS dhe operatori ekonomik.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<i>[shëno te dyja]</i> a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykata Themelore në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë</b> ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</i> në pajtim me <i>[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)]</i> .



## **PJESA IV E KONTRATËS: MODEL I SIGURISË SË EKZEKUTIMIT**

*[Me logon e institucionit financiar që e jep sigurinë]*

**Për: MINISTERIA E PUNES DHE MIREQENIES SOCIALE**

(në vazhdim: “autoriteti kontraktues”)

Në emër të: *[emri dhe adresa e operatorit ekonomik]*

(në vazhdim “operatori ekonomik”)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Renovimi i QAP Gjilan dhe QAP Prizren, 2019**

Numri i Prokurimit: **209-19-6649-5-2-1**

### **Garancion me kërkesë të pare**

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: < *shuma e sigurisë me fjalë dhe shifra* > zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe
- b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: < *shuma e garantuar* > siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin “e pranimit”.

**Kjo siguri vlen deri me: < *data dhe koha* >**

*Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve*

*Emri i institucionit financiar*

*Adresa*

*Data*

Numri i Prokurimit:

- Titulli

### PJESA V E KONTRATËS: IDENTIFIKIMI FINANCIAR

MBAJTËSI I LLOGARISË	
Emri	"TRIANGLE" SHPK
Adresa	RR. BRIGADA 123 pm
Qyteti	SUHAREK
Kodi Postar	23 000
Kontakti	ARIAN BYTYÇI
Telefoni	049/044- 479 341
Fax	
E-mail	triangle.shpk@gmail.com
Numri i TVSH	330363482

BANKA	
Emri	BPB
Adresa	SUHAREKË-KOSOVË
Qyteti	SUHAREKË
Kodi Postar	23 000
Shteti	KOSOVË
Llogaria Bankare	13-01-0010026027.08
IBAN (opcionale)	
BIC (Opcionale)	

#### SHËNIME:





## **ANeks 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME**

1. Përshkruaj specifikimet teknike, në mënyrë jo diskriminuese, karakteristikat e detyrueshme të objektit të kontratës siç janë: Kualiteti, sigurimi i kualitetit, performanca, terminologjia, kërkesat e dizajnit, simbolet, dimensionet, testimi dhe metodat e testimit, sigurimi, paketimi, shënjimi, etiketimi.

Specifikimet teknike duhet të përpilohen në mënyrë që të përputhen me qëllimin e prokurimit dhe të ofrojnë qasje sa më të madhe të operatorët ekonomik të interesuar.

Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar të vendosë specifikime teknik që favorizojnë ose disfavorizojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

[2. Nëse variantet lejohen Autoriteti Kontraktues duhet të ceket specifikimet minimale që duhet të përmbushen nga një variant dhe çdo kërkesë specifike për prezantimin e variantit të tillë janë]

[Indikacion për ndryshimin e datës së fillimit/dorëzimit (nëse zbatohet):]

[Fillimi:]

< shëno datën >

[Dorëzimi:]

< shëno datën >

[Informacionet teknike të detajuara mund të shkruhen në gjuhën që zakonisht shfrytëzohet ndërkombëtarisht për teknikën e tillë]

1. **Të respektohen të gjitha normat, standardet teknike ndërtimore**
2. **Të respektohet plotësisht Ligji i Ndërtimit**
3. **Të zbatohet përshkrimi teknik, gjegjësisht projekti**

## Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [“TRIANGLE” SHPK ] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklaratë që përmban informata përmbajtësive të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	“TRIANGLE” SHPK
Adresi e plotë:	RR. BRIGADA 123pn SUHAREKË
I përfaqësuar nga:	
Emri:	ARIAN BYTYÇI
Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:	
Data:	23.09.2019
Vula:	



**Prokurimi: 209-19-6649-5-2-1**

**Nr i brendshëm: 209/19/034/521**

**Tituli: Renovimi i QAP Gjilan dhe QAP Prizren, 2019**

**1 Renovimi i QAP Gjilan dhe QAP Prizren, 2019**

**Kodi i tenderit: 046T/2019**

**Data: 21.09.2019**

**Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse**

---

<b>Nr.</b>	<b>Dokument</b>
1.	1 Deklarata nen Betim.pdf
2.	2 Qertifikata biznesit TVSH.pdf
3.	3 Qarkullimi Bankar.pdf
4.	4 Lista e projekteve Referencat.pdf
5.	5 Lista e stafit.pdf
6.	6 Isot.pdf
7.	7 Lista e Puntorve.pdf
8.	8 Mjetet e punes-makineria.pdf
9.	9 Plani Dinamik.pdf
10.	10 Sigurimi i Tenderit.pdf

**Përshkrimi i çmimeve**

---

<b>Nr</b>	<b>Emërtimi i grupit</b>	<b>Dokumenti</b>
1.	Renovimi i QAP Gjilan dhe QAP Prizren, 2019	PARAMASA.pdf

**Pjesët e tenderit që do të dorëzohen ndaras:**

---

Nuk ka

## **AUTORITETI KONTRAKTUES**

---

**MINISTRIA E PUNES DHE MIREQENIES SOCIALE, Mis Edit Durham Nr.46, 10000, PRISHTINË,**

**Zyrtari përgjegjes i prokurimit:**

**Nr i Prokurimit: 209-19-6649-5-2-1**

### **OPERATOR EKONOMIK:**

---

**Emri i kompanisë dhe adresa e plote: "TRIANGLE" SH.P.K., rr.Brigada123, 23000, Suharekë, Kosovë**

**E-mail: [tiangle.shpk@gmail.com](mailto:tiangle.shpk@gmail.com)**

**Personi kontaktues: Arian Bytyçi**

**Telefoni: 049 479 341**

**Faxi:**

**Numri fiskal: 810048167**

**Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):**



## FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

### Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 209-19-6649-5-2-1

Titulli i kontratës: **Renovimi i QAP Gjilan dhe QAP Prizren, 2019**

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

#### **I Renovimi i QAP Gjilan dhe QAP Prizren, 2019**

3. Çmimi total i tenderit është:

**57.824,70 EUR**

Dhe në fjalë [*shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro*]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 60 nga data finale për dorëzim të tenderëve.
5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës
6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [*shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet*] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [*shëno emrin e udhëheqësit*]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.
7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK
8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj

nesë nëse e bën këtë.

**Informacion në lidhje me nënkontraktorët**

Emri dhe adresa e nënkontraktorit	Numri fiskal - nënkontraktorë	Përshkrimi i pjesës së kontratës që do të nënkontraktohet	Pjesa vlera të nënkontraktohet	Përqindja e kontratës që do të nënkontraktohet (%)





**Punimi I Kulmit Ndriqes (Llanterna) mbi korridorin qendor - Qendra per Aftesim Profesional**

**Paramasa dhe Paralogaria**

Pjesë përberese e Paramases dhe paralogarisë - ESHTE EDHE: PROJEKTI Detali "Llanterna" dhe Instruksionet nga prodhuesi. Në kuadrin e punimeve të përfshihet - Sjellja e materialeve në punishte, menaxhimi dhe siguria e materialeve dhe rrethitës së punishte dhe vuarja e materialeve në veper, përfshi të gjitha punimet dhe aktivitetet në funksion të finalizimit dhe funksionalizimit të mbuleses (Llanternes) sipas destinacionit për shfrytëzim, mirëmbajja e sistemeve deri në skadim të periudhës së garancionit të punimeve.

Nr.	Pershkrimi I Punimeve	Njesia	Sasia	€/Njesi	€/Sasi
<b>1.0 Fabrikimi dhe Montimi I Llanternes Ndriqese</b>					
1.1	Demolimi I kontrolluar dhe largimi I strukture egzistuese te mbuleses: muret e kallkanit dhe perimetrike siper serkllazhit egzistues, sipas instruksioneve nga mbikqyersi.	m <sup>2</sup>	64	5.00	320.00
1.2	Sjellja materialeve dhe masat preventive per siguri nga reshjet dhe demtimet te strukturave qe nuk largohen - zona e brenshme nen llanterne, perfshi plafoni I varun.	LS	1	150.00	150.00
1.3	Fabrikimi, sjellja dhe montimi I pllakave ankoruese, nga çeliku I ngjyrosur, pllakat me dimensione 160x200x6mm, perfshi ankorimet per bazen. Sipas detalit "Llanterna",	Copë	20	15.00	300.00
1.4	Fabrikimi, sjellja dhe montimi I mbajtesve primar "05" nga çeliku. Sipas detalit "Llanterna",	Copë	5	110.00	550.00
1.5	Fabrikimi, sjellja dhe montimi I mbajtesve sekondar "03" nga çeliku. Sipas detalit "Llanterna",	m'	78	10.00	780.00
1.6	Fabrikimi, sjellja dhe montimi I mbajtesve terclar "04" nga alumini dhe goma ujimbajtese. Sipas detalit "Llanterna" dhe instruksioneve nga prodhuese.	m'	97	20.00	1940.00
1.7	Fabrikimi, sjellja dhe montimi I paneleve jo transparente mbuluese alumini (senwich) me poliuretane dhe profilimet uji-izoluese perimetrike, me mbeshtetje ne profilet terciare, sipas detalit "Llanterna" dhe instruksioneve nga prodhuese.	m <sup>2</sup>	14.5	45.00	652.50
1.8	Fabrikimi, sjellja dhe montimi I paneleve transparente mbuluese nga panelet e qelqit te kalitur me mbushje gazi (argon), perfshi profilimet uji-izoluese perimetrike, me mbeshtetje ne profilet terciare, sipas detalit "Llanterna" dhe instruksioneve nga prodhuese.	m <sup>2</sup>	53.2	65.00	3458.00
1.9	Sjellja e materialit dhe punimi I muratimeve specifike sipas detalit "Llanterna". Muratimet punohen nga bllloqet e gazbetonit me formatizime sipas specifikeve ne vend, përfshi llaqin standard lidhes.	m <sup>3</sup>	7	35.00	245.00



1.10	Sjellja e materialet dhe suvatimi I brenshem perimetrik me llaq te parafabrikuar "NP75", sipas detalit "Llanterna". Perfshi paraljerjen me ngjites, perforcimet me rrjete polikarboni dhe aksesoret metalik percjelles per formatizime.	m <sup>2</sup>	30	7.50	225.00	
1.11	Sjellja e materialit dhe patimimi (perfshi sanimin e zones se poshtme) me llaq te gipsit, perfshi ngjitesin dhe ngjyrosjen sipas instruksioneve nga mbikqyersi.	m <sup>2</sup>	64	3.50	224.00	
1.12	Sjellja e materialit dhe mbeshtjellja perimetrika (nga jasht) me pllaka "aquapanel", 1x12.5mm, perfshi aksesoret metalik "Knauf" (ose ngjashem) per ankorim dhe patinimin me ngjyrosje me ngjyre plastike, siperfaqesore. Sipas detalit "Llanterna",	m <sup>2</sup>	25	20.00	500.00	
1.13	Sjellja e materialit dhe sanimi I fasades perimetrike (nen zonen me aquapanel), perfshi shtresat: sanimi I shtreses se styroporit egzistues + suvatimi I llaq te qimentos ne dy shtresa + vensosja e rrjete se polikarbonit + ankorimet metalike 5 ankorime.m2 + vensosja e shtrese se fasades 0.15mm + ngjyrosja me ngjyre plastike.	m <sup>2</sup>	52	20.00	1040.00	
1.14	Fabrikimi, sjellja dhe montimi I kulmar-mbuleses "10" nga profilimi me llamarin te plastifikuar dhe ngjyrosur, t=0.7mm, perfshi ankorimet metalike. Sipas detalit "Llanterna" dhe instruksioneve nga mbikqyersi.	m <sup>2</sup>	13	15.00	195.00	
1.15	Sjellja e materialit dhe punimet preventive per kulmin egzistuese, nen zonen perimetrike te llamternes.	m <sup>2</sup>	60	5.00	300.00	
					€ / 1.0:	10879.50

Nr.	Pershkrimi I Punimeve	Njesia	Sasia	€/Njesi	€/Sasi
-----	-----------------------	--------	-------	---------	--------

#### 2.0 Fabrikimi dhe Montimi I paneleve te dyerve hyrse

2.1	Largimi I paneleve - dyerve egzistuese. Demolimi beht I kontrolluar pa demtime rrethanore. Materiali I demoluar largohet sipas instruksioneve nga mbikqyersi,	m <sup>2</sup>	22.3	15.00	334.50
2.2	Sjellja e materialit dhe sanimi I perimetrit te paneleve te dyerve - sanimet ne mure dhe plafon (pa plafon te varun), me :Suvatim te demtimeve; patinim te demtimeve dhe ngjyrosje te demtimeve.	m'	14.18	7.00	99.26

2.3	Sjellja e materialit dhe sanimi I perimetrit te panelleve te dyerve - sanimet ne plafon, me : sanimi I plafonit te varun me nderrim ne shirit nga 1m nga profili, ku nderrohet ose sanohet sistemi mbajtes, nderrohen pllakat armstrong dhe aksesoret percjelles.	m <sup>2</sup>	13	6.50	84.50
2.4	Sjellja e materialit dhe sanimi I dyshemese me: ripunim I pjeseshem I estrihut; ripunim I pjeseshem I hydroizolimit; ripunim I pjeseshem I pllakat nga graniti artificial - t=10mm, perfshi sokllen.	m <sup>2</sup>	12.6	75.00	945.00
2.5	Fabrikimi, sjellja dhe montimi I deres se jashtme (J) nga PVC dhe qelqi , 320x340cm, sipas skemes grafike "J",	Copë	1	1200.00	1200.00
2.6	Fabrikimi, sjellja dhe montimi I deres se brenshme (M), nga PVC dhe qelqi, 310x368mm, sipas skemes grafike "J",	Copë	1	1050.00	1050.00

€/ 2.0: 3713.26

Nr.	Pershkrimi I Punimeve	Njesia	Sasia	€/Njesi	€/Sasl
3.0	Punet tjera				
3.1	Demolimi i murit ndares tek I cili parapeti ka lartesi P=95cm pjesa tjetere eshte nga konstruksioni mbajtes dhe xhami per krijimin e hapësires per vendosjen e deres per te daluar ne ballkon. Ne cmim te parashihet dhe adaptimi I murit per deren e re	m2	3	10.00	30.00
3.2	Fabrikimi, sjellja dhe montimi I deres se ballkonit me dimensione 90x210, , lloji dhe ngjyra zgjidhet nga investitori,organi mbiqkyres.	cope	1	250.00	250.00
3.3	Fabrikimi, sjellja dhe montimi I ollukut horizontal, lloji dhe ngjyra sikurse ato ekzituese. Ne cmim te perfshihen dhe kthesat, mbajtesit sidhe te gjitha elementet tjera e nevojshme per kompletim .	m	10	7.50	75.00
3.4	Fabrikimi, sjellja dhe montimi I ollukut vertikal, lloji dhe ngjyra sikurse ato ekzituese. Ne cmim te perfshihen dhe kthesat, mbajtesit sidhe te gjitha elementet tjera e nevojshme per kompletim .	m	12	6.50	78.00
3.5	Furnizimi transporti dhe montimi I nje ventilatori me kapak, me kapacitet 20W, . ne qmimi te perfshihet hapja e vrimes, adaptimet pas montimit,kanalet dhe kablllo e nevojshme sipas gjendjes ne teren per funksionalizim.	cope	2	65.00	130.00



3.6	Furnizimi, transporti dhe montimi-zevendsimi i pllakave ne tavanin e varur "Amstrong" sikurse ato ekzistuese, ne konstruksionin ekzistues. Ne cmim te perfshihet dhe largimi i pllakave te cilat zevendsohen deri ne deponi te caktuar nga Investitori	m2	35	8.00	280.00
				€/ 3.0:	843.00

**RIKAPITULLIMI:**

1.0	Fabrikimi dhe Montimi i Llanternes Ndriqese	10879.50
2.0	Fabrikimi dhe Montimi i paneleve te dyerve hyrse	3713.26
3.0	Punet tjera	843.00
		€/Total: 15435.76

VËREJTJE: TË GJITHA PRODHIMET KU JANË PËRMENDUR EMRAT E PRODHUESVE MUND TË SIGUROHEN PRODHIME TË NGJAJSHME ME KARAKTERISTIKA TË NJËJTA OSE MË TË MIRA

KONTROLLOJENI FORMULËN QË TË PËRFSHIHEN TË GJITHA POZICIONET, AUTORITETI KONTRAKTUES NUK MBAN PËRGJEGJËSI PËR GABIMET EVENTUALE NË FORMULË.



**QAP-Prizren**

Nr.	Specifikimi I Punimeve	Njesija	Sasia	€ / Njesi	€ / Sasi
1	<b>Mobilizimi</b>				
1.1	Mobilizimi i kompanisë dhe konzervimi - ruajtja e paisjeve të cilat nuk do të hiqen. Te ruhen dhe te kthehen prap ato paisje që duhet te kthehen ne vendin qe e percakton Investitori/organi mbikqyres	komplet	1	250.00 €	250.00
					250.00

Nr.	Specifikimi I Punimeve	Njesija	Sasia	€ / Njesi	€ / Sasi
2	<b>Punët e Demolimit</b>				
2.1	Demolimi i pllakave te qeramikes nga siperfaqja e dyshemes në kthinat si ne skic, te perfshihet edhe demolimi i shtreses rrafshuese-estrih. Ne cmim te perfshihet transporti i materialit te demoluar deri ne deponi qe e cakton Investitori/Organi Mbikqyres.	m2	52	3.00 €	156.00
2.2	Demolimi i pllakave te qeramikes nga siperfaqja e mureve në(toalete) kthinen si ne skic. Ne cmim te perfshihet transporti i materialit te demoluar deri ne deponi qe e cakton Investitori/Organi Mbikqyres.	m2	41	3.00 €	123.00
2.3	Demolimi i paisjeve te sanitarise ne tualete( nr.4, 5,6): llavabo, guaska,ujembledhesa, krojet, sifona, gypa dhe aksesoret percjellese Ne cmim te perfshihet transporti materialit te demoluar deri ne deponi qe e cakton Investitori/Organi Mbikqyres.	Komplet	1	200.00 €	200.00
2.4	Demolimi i dyerve së bashku me ramin, me dimensione sipas skices.Ne cmim te perfshihet transporti materialit te demoluar deri ne deponi qe e cakton Investitori/Organi Mbikqyres.	copë	8	15.00 €	120.00
2.5	Demolimi i dritareve, me dimensione sipas skices. Ne cmim te perfshihet transporti materialit te demoluar deri ne deponi qe e cakton Investitori/Organi Mbikqyres.	copë	10	10.00 €	100.00
2.6	Demolimi i xhamave ne dritaret ekzituese (4 dritare me nga 7 xhama) , heqja e tyre te behet me kujdes ne menyre qe te mos demtohen pjeset tjera te dritares dhe te pergaditen per montimin e xhamave te rinje. Ne cmim te kalkulohet edhe demolimi i te gjitha pjeseve te tjera te panevojshme si dhe transporti i materialit te demoluar deri ne deponi qe e cakton Investitori/Organi Mbikqyres.	copë	28	5.00 €	140.00
					839.00

Nr.	Specifikimi I Punimeve	Njesija	Sasia	€ / Njesi	€ / Sasi
3	<b>Punët e Muratimit</b>				
3.1	Furnizimi, transporti dhe punimi murit nga bllokot te argjiles( me trashesi d=25cm) "Gjysem giter" bllok, në pjesen ku eshte demoluar dera.	m3	0.5	22.00 €	11.00
					11.00

Nr.	Specifikimi I Punimeve	Njesija	Sasia	€ / Njesi	€ / Sasi
4	<b>Perpunimi Final I Mureve te Brendshme</b>				
4.1	Demolimi i suvasë së demtuar	m2	100	2.00 €	200.00
4.2	Pastrimi dhe gryerja e siperfaqeve te murit ekzistues, nga mbetjet dhe papastertinat siperfaqesore.	m2	420	1.00 €	420.00
4.3	Punimi i shtreses se pare nga qumshli i cimentos. Aplikohet ne muret e punuara me blloka te argjiles per lidhjen ne mes te murit dhe suvasë.	m2	100	1.00 €	100.00





4.4	Suvalimet e parapara duke përdorur rjetimet (një ose më shumë shtresa me ngjitës) për lidhjen e materialeve me ankorime metalike si masa paraprake para suvalimeve finale me llaç të parapërgatitur "MP75" apo ngjashëm (t=10mm(max.)). Suvalimi në vete përmban edhe kompletimin me këndore metalike dhe pajisje tjera përcjellëse për formime të kërkuara gjeometrike. Para suvalimeve finale, në zonat me deformime të theksuara sipërfaqësore bëhet para-suvalimi me llaç natyral (rëre : çimento: gëlqere = 6 : 3 : 0.5) si masë nivelizuese për t'iu shmangur trashësive të mëdha me suvalim të parafabrikuar, natyrisht me përdorim paraprak dhe pas lyerjeve me bazën ground (ngjitës) për lidhje dhe rjetime përforcuese. Ne cmim te perfshihen edhe kendoret reth dyereve dhe dritareve.	m2	100	6.50 €	650.00
4.5	Patenimi i sipërfaqësore mbi muret e suvatuara, sipërfaqet me suvalim nga llaçi me bazë çimentoje dhe baze gipsi. Përdoren materiale të familjes së llaçrave "gletofix" apo të ngjashme duke para-përdorur lyerjet për ngjitje të shtresave njëra mbi tjetrën, përfshirë dhe aksesorët për formime të rregullta gjeometrike. Llogaritja e punimeve të realizuara në "m2" neto sipërfaqe të realizuar. Ne cmim te perfshihet sanimi i demtimeve ne mure.	m2	420	3.00 €	1260.00
